



Në bazë të nenit 65 alinea (6) nga Ligji për ambijent jetësor (Gz. Zyrtare e RM nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16, 42/16 dhe 99/18), Komuna Saraj, më 18.09.2019 viti, solli

Vendim për zbatimin e vlerësimit strategjik

1. Për dokumenton e planit PUJVB për qendrën sportive rekreative Treska, v.q. Livadhe, KK Gllumovë dhe KK Shishovë, Komuna Saraj, nevojitet të realizohet vlerësim strategjik të ndikimit ndaj ambijentit jetësor në pajtim me nenin 65 nga Ligji për ambijentin jetësor.
2. Si organe të prekura nga zbatimi i PUJVB për qendrën sportive Rekreative Treska, v.q. Livadhe, KK Gllumovo dhe KK Shishovë, komuna Saraj përcaktohen si më poshtë: komuna e Sarajit, Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, Ministria e transportit dhe lidhjeve, Ministria e shëndetësisë, Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, Ministria e ekonomisë.
3. Për dokumentin e planifikimit PUJVB për qendrën sportive Rekreative Treska, v.q. Livadhe, KK Gllumovo dhe KK Shishovë, komuna e Saraj, për të cilën është përgjegjës Pro-inzhenering Tetovë, dhe e miraton komuna Saraj, miratimi i dokumentit të planifikimit PUJVB për qendrën sportive dhe rekreative Treska, v.q. Livadhe, KK Gllumovo dhe KK Shishovë, komuna e Sarajit do të ketë ndikim mbi mjedisin jetësor.
4. Fushëveprimi i raportit të vlerësimit strategjik duhet të përfshijë këto aspekte: ndikimin në ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ndikimin në zonë, ndikimin në biodiversitetin, ndikimin në truallin dhe ndikimin në gjenerimin e mbeturinave.
5. Vendimi së bashku me formularin për përcaktimin e nevojës për kryerjen e vlerësimit strategjik publikohet në veb faqen e komunës së Sarajit në: www.saraj.gov.mk.
6. Publiku ka të drejtë të ankohet kundër këtij vendimi në Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, brenda 15 ditëve nga publikimi i vendimit në faqen e internetit.

Nr.08-1734
Data: 18.09.2019
Komuna Saraj

Emri dhe mbiemri
Kryetar
Blerim Bexheti